REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

Nr. 5956/1 Prot.

Lushnje, më 14/07/2025

PROJEKT-VENDIM
Nr 68 Datë 14 .07.2025

KËSHILLIT BASHKIAK
MBI NJË SHTESË NË BUXHETIN E VITIT 2025
NGA TË ARDHURAT E TRASHËGUARA
(Miratuar me VKB nr.112 datë 26.12.2024)

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ___/____/ 2025, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë "**Mbi një ndryshim dhe shtesë në Buxhetin e Vitit 2025 nga te ardhurat e trasheguara ",** mbështetur në Ligjin nr. 139 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, neni 54 germa dh, në Ligjin Nr.115/2024, "Për buxhetin e vitit 2025", në Ligjin nr.9936 datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në Udhëzimin nr.9 datë 20.03.2018 të Ministrisë së Financave "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit" të ndryshuar.

PROPOZOJMË:

Të shtohet Buxheti i vitit 2025 nga të ardhurat e trasheguara nga viti 2024 në vlere **66,796,000** lekë si më poshtë:

1 . Shtesë nga të ardhurat e trashëguara nga viti 2024 në vlerën 1,428,400 lekë për blerjen e mobiljeve të shkollës "Hysen Xheka" Karbunarë

a. Të rriten të ardhurat e trashëguara të buxhetit për vitin 2025 për vlerën 1,428,400 lekë.
b. Të rriten shpenzimet për vitin 2025 për vlerën 1,428,400 lekë.
Rritja do të shkojë në:
Në Qendren e Arsimit në programin AC129 " Arsimi " (00-05-AC129-231-P912AAH) për 1,428,400 lekë

2. Shtesë nga të ardhurat e trasheguara nga viti 2024 në vlerën 60,000,000 lekë për shpenzimet e vitit 2025 për Produktin V452AAB "Rrjet Rrugor Rural i mirëmbajtur":
a. Të rriten të ardhurat e trashëguara të buxhetit për vitin 2025 për vlerën 60,000,000 lekë.
b. Të rriten shpenzimet për vitin 2025 për vlerën 60,000,000 lekë.
Rritja do të shkojë në:

Në Ndërmarja e Pasurisë Publike në programin AB129 "Rrjet Rrugor Rural i mirëmbajtu" (00-01-AB129-602-V452AAB) për 60,000,000 lekë.

Adresa:Lagjja Kongresi Lushnjes Tel:+355 35 222139 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com

3. Shtesë nga të ardhurat e trasheguara nga viti 2024 në vlerën 367,600 lekë për shpenzimet e vitit 2025 për Produktin V424AAB (AB129-00-01-602)

a. Të rriten të ardhurat e trashëguara të buxhetit për vitin 2025 për vlerën 367,600 lekë.
b. Të rriten shpenzimet për vitin 2025 për vlerën 367,600 lekë.

Rritja do të shkojë në:

Në Ndermarja e Pasurise Publike në programin AB129 "Shërbimet Publike Komunitare" (00-01-AB129-602- V424AAB) për 367,600 lekë

4. Shtesë nga të ardhurat e trasheguara nga viti 2024 në vlerën 5,000,000 lekë për shpenzimet e vitit 2025 për Produktin V813AAC "Mbështetje për Klubin e Futbollit":

a. Të rriten të ardhurat e trashëguara të buxhetit për vitin 2025 për vlerën 5,000,000 lekë.
b. Të rriten shpenzimet për vitin 2025 për vlerën 5,000,000 lekë.

Rritja do të shkojë në:

Në Qendra e Kulturës & Klubi i Futbolli në programin AE129 " Mbështetje për Klubin e Futbollit" në Programin "Art, Kulturë, Sport & Turizëm" (00-05-AE129-603- V813AAC) për 5,000,000 lekë

5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Qendra e Arsimit, Ndërmarja e Pasurisë Publike, Qendra e Kulturës & Klubi i Futbolli dhe Drejtoria e Financë-Buxhetit.
6. Vendimi hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

DREJTORIA FINANCË –BUXHETIT
Ervisa ÇUKO

DREJTORIA JURIDIKE
Bedri HIDA

KRYETAR I BASHKISË
Eriselda SEFA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA LUSHNJE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

Nr.5956Prot. Lushnje, më 14/07/2025

RELACION

KËSHILLIT BASHKIAK
MBI NJË SHTESË NË BUXHETIN E VITIT 2025
NGA TË ARDHURAT E TRASHËGUARA
(Miratuar me VKB nr.112 datë 26.12.2024)

Të nderuar zonja dhe zotërinj këshilltar!

Bazuar në Ligjin Nr .139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjin Nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", Ligjin Nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Ligjin Nr. 115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025", Udhëzimi Nr. 2 datë 24.01.2025 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025", Udhëzimit Nr. 9 datë 20.03.2018 "Për proçedurat standarte të zbatimit të buxhetit", si dhe mbas rakordimit të ardhurave të trashëguara nga viti 2024 për në.vitin 2025 te cilat ishin 566,697,377 lekë, nga të cilat 180,000,000 lekë janë miratuar dhe shpërndarë në buxhetin e vitit 2025 si dhe shtesa në buxhet nga te ardhurat e trashëguara sipas VKB nr 26 datë 25.02.2025 me vlerë 33,971,939 lekë,VKB nr 34 datë 01.04.2025 në vlerë 1,200,000 lekë, VKB nr 47 datë 30.05.2025 në vlerë 31,183,182 lekë dhe VKB nr 58 datë 30.06.2025 me vlerë 6,320,320 lekë. Nga vlera e mbetur e të ardhurave të trashëguara nga viti 2024 ne vitin 2025, pas rakordimev me degën e thesarit, gjendja e fondeve të trashëguara vazhdon të jetë e lartë, për këtë arsye mendojmë të bëjme një shtesë në buxhet nga këto të ardhura të trashëguara nga viti 2024 në vlerën **66,796,000 lekë** për vitin 2025. Shtesa në Buxhetin e vitit 2025 do të shkoj për:

1.Në mbështetje të ligjit nr 9901 datë 14.04.2008 "Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare" neni 135, pika 2 gërma "e" si dhe të statutit të Sh.A "Tregu i Shitjes me Shumicë Fruta-Perime Lushnje" si dhe shkresës me nr 5068 prot datë 17.06.2025 "Kërkesë për fond" nëpërmjet të cilës Bashkia Lushnje është drejtuar Këshillit Mbikqyrës të Sh.A "Tregu i Shitjes me Shumicë Fruta-Perime Lushnje" për financimin për blerjen e mobiljeve të shkolles 9-vjecare "Hysen Xheka" në lagjjen Karbunarë, Lushnje. Në mbledhjen e Asamblesë së SH.A "Tregu i Shitjes me Shumicë Fruta-Perime Lushnje", datë 30.06.2025, "Për miratimin dhe shpërndarjen e fitimit të vitit ushtrimor 2024 në vlerën 2,114,391 lekë dhe miratimin e fondit për Bashkinë Lushnje" me vendimin nr 04 datë 30.06.2025 vendosën që fitimi i kësaj SH.A të shkoj për blerjen e mobiljeve për shkollën "Hysen Xheka". Shuma që SH.A "Tregu i Shitjes me Shumicë Fruta-Perime Lushnje", do të shpërndarjë nga fitimi i vitit 2024 është 2,114,391 lekë, nga të cilat 1,945,240 do të shkojnë për financim për blerje mobilje për shkollën "Hysen Xheka"

Adresa:Lagjja Kongresi Lushnjes Tel:+355 35 222139 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com

dhe vlera 169,151 lekë do të shkoj për pagesën e dividentit nga shpërndarja e fitimit të vitit 2024 në llogari të DPT Fier. Sipas preventivit të përllogaritur, vlera totale e mobiljeve është 3,373,628.4 lekë. Gjatë mbledhjes së GMS u diskutua të përdoret nga të ardhurat e trasheguara vlera 1,428,400 lekë për blerje mobilje për shkollen "Hysen Xheka" Karbunarë.

a. Të rriten të ardhurat e trashëguara të buxhetit për vitin 2025 për vlerën 1,428,400 lekë.
b. Të rriten shpenzimet për vitin 2025 për vlerën 1,428,400 lekë.
Rritja do të shkojë në:
Në Qendren e Arsimit në programin AC129 " Arsimi " (00-05-AC129-231-P912AAH) për 1,428,400 lekë

2. Bazuar ne VKB nr 114 date 26.12.2025 "Mbi një shtesë në Buxhetin e vitit 2024 (transfertën e pakushtëzuar të vitit 2024) miratuar me vkb nr 103 date 21.12.2023" transfertë me vlerë 20,000,000 lekë e cila erdhi në fund të vitit 2024 dhe u trashëgua me fondet e 2024 pasi nuk mund të kryheshin procedurat e prokurimit sipas afateve ligjore. Gjithashtu mendojmë të përdorim edhe një vlerë shtesë prej 40,000,000 lekë në Programin AB129, pra të përdorim të ardhurat e trasheguara nga viti 2024 vlerën prej **60,000,000 lekë** për shpenzimet e vitit 2025 për Produktin V452AAB "Rrjet Rrugor Rural i mirëmbajtur", sipas diskutimeve me Grupin e Menaxhimit Strategjik për fonde shtesë për shtrimin e disa rrugeve, u propozua që të bëhej një shtesë nga të ardhurat e trasheguara në vlerën 60,000,000 lekë në Programin AB129 (00-01-V452AAB-602):

a. Të rriten të ardhurat e trashëguara të buxhetit për vitin 2025 për vlerën 60,000,000 lekë.
b. Të rriten shpenzimet për vitin 2025 për vlerën 60,000,000 lekë.
Rritja do të shkojë në:
Në Ndermarja e Pasurise Publike në programin AB129 " Shërbimet Publike Komunitare" (00-01-AB129-602- V452AAB) për 60,000,000 lekë

Të gjitha këto fonde do të shkojnë në Programin AB129 në Ndërmarjen e Pasurisë Publike në Produktin V452AAB "Rrjet Rrugor Rural i mirëmbajtur" për blerjen e materialeve për shtrimin e rrugeve të ndryshme.

3. Bazuar në VKB nr 55 datë 22.05.2024 në të cilin është miratuar projekti "Rehabilitimi i kanalit ujitës U-3-25/1,U-3-25/2,U-3-24", Njësia Administrative Krutje", procedura e të cilit është ndjekur nga Ndërmarja e Pasurisë Publike, fondet e të cilit janë alokuar nga Ministria e Financave, pagesa e fundit është bërë në fillim të vitit 2025. Fondi i alokuar nga Ministria mbuloi vetëm vlerën e projektit. Për këtë projekt janë lidhur edhe kontratat e mbikqyrjes dhe kolaudimit të punimeve por nuk është alokuar fond nga ana e Ministrisë së Financave. Kërkojmë një shtese ne Buxhetin e vitit 2025 për likujdimin, konkretisht për dy kontratat që lidhen me investimin e më sipërm "Kolaudimin e kanalit" me kontratë Nr 1289 Prot dt 24.09.2024 me vlerë 43,398.8 lekë dhe "Mbikqyrja e Punimeve" me kontratë Nr.1314 prot dt 01.10.2024 me vlerë 324,189.86 të parashikuara për likujdim me fondet e viti 2025 me kodë projekti 18AJ971 me artikull 231. Duke qenë se fondi i akorduar nga Ministria e Financave për vitin 2025 ishte vetëm për vlerën e investimit sipas shkresës së ardhur nga ministria, kërkojmë që këto dy pagesa të kryhen nga fondet tona në Programin AB129 (00-01-602-V424AAB) në vlerën 367,600 lekë

a. Të rriten të ardhurat e trashëguara të buxhetit për vitin 2025 për vlerën 367,600 lekë.
b. Të rriten shpenzimet për vitin 2025 për vlerën 367,600 lekë.
Rritja do të shkojë në:
Në Ndermarja e Pasurise Publike në programin AB129 "Shërbimet Publike Komunitare" (00-01-AB129-602- V424AAB) për 367,600 lekë.

4. Në programin AE129 (Art, kulturë sport) që mbulohet nga Ndërmarrja Qendra e Kulturës & Klubi i Futbolli. Shtesa të shkojë në program në artikullin 603, në produktin V813AAC në vlerën 5,000,000 lekë për Klubi i Futbollit Lushnja 1930.

a. Të rriten të ardhurat e trashëguara të buxhetit për vitin 2025 për vlerën 5,000,000 lekë.
b. Të rriten shpenzimet për vitin 2025 për vlerën 5,000,000 lekë.

Rritja do të shkojë në:

Në Qendra e Kulturës & Klubi i Futbolli në programin AE129 " Mbeshtetje per Klubin e Futbollit" Shërbimet Publike Komunitare" (00-05-AE129-603- V813AAC) për 5,000,000 lekë

Grupi i Menaxhimit Strategjik :

Drejtoria Fianacë - Buxhetit
Ervisa Çuko

Drejtoria të Ardhurave Vendore
Donald Nushi

Drejtora e Përgj i Zhvill Urban dhe Rural
Mimoza Haxhiu

Drejtoria e Burimeve Njerëzore
Erisa Qalliu

Drejtoria Juridike
Bedri Hida

Drejtoria e Shërbimit Social
Anila Çela

Ndërmarrja Pasurisë Publike
Evis Qyra

Qëndra Kulturore&Klub Shumë Sport.
Brizida Dervishi

Qëndra e Arsimit
Muarrem Sharka

KRYETAR I BASHKISË
Eriselda SEFA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA LUSHNJE

Adresa:Lagjja Kongresi Lushnjes *Tel:+355 35 222139* *E-mail.bashkia_lushnje@yahoo.com*